



**HIDRODRINI**

Zyret qendrore  
Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë  
Telefoni: 039 / 432 355



# MARRËVESHJE PËR SHËRBIME TË UJËSJELLËSIT DHE UJËRAVE TË NDOTURA

në mes të:

**KOMUNËS SË KLINES**

dhe

**KRU "HIDRODRINI" SH.A. PEJË**

02/10/2023

Kjo Marrëveshje për Shërbime (në tekstin e mëtutjeshëm: "Marrëveshje") është bërë më datë \_\_\_/\_\_\_/2023 nga dhe në mes të Komunës së Klines (në tekstin e mëtutjeshëm: "Komuna") dhe Kompanisë Rajonale të Ujit "Hidrodrini" Sh.A. (në tekstin e mëtutjeshëm: "KRU") me seli në Pejë në Rr. "Lekë Dukagjini" Nr.156

Komuna dhe KRU, në tekstin e mëtutjeshëm referohen bashkërisht si "Palët".

## **Neni 1** **Qëllimi**

1. Marrëveshja ka për qëllim që t'i përshkruaj të drejtat dhe obligimet mes Palëve lidhur me operimin dhe ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura në territorin e komunës në përputhje me legjislacionin në fuqi të Kosovës dhe duke pas parasysh se:
  - 1.1. *KRU është pronare e aseteve që shërbejnë për furnizimin me ujë dhe për ofrimin e shërbimeve të ujërave të ndotura dhe, rrjedhimisht, përgjegjëse për operimin, mirëmbajtjen, përtëritjen dhe zgjerimin e këtyre aseteve,*
  - 1.2. *Me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Komuna ka kompetenca ekskluzive për ofrimin e shërbimeve publike të furnizimit me ujë dhe shërbimet e kanalizimit të ujërave të ndotura,*
  - 1.3. *Me Ligjin për Ndërmarrje Publike, KRU-të janë Ndërmarrje Publike në pronësi të Republikës së Kosovës mbi të cilat të drejtat e aksionarit i ushtron Qeveria e Republikës së Kosovës,*
  - 1.4. *Me Ligjin nr. 05/l-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, është përcaktuar që shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura mund të ofrohen vetëm nëse ofruesi i shërbimeve posedon licencë të shërbimit të lëshuar nga Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit,*
  - 1.5. *Me Ligjin nr. 06/l-088 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 05/l-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, është përcaktuar kërkesa që KRU duhet të pranojë përgjegjësinë për ofrimin e shërbimeve përmes marrëveshjes për shërbime me komunat në tërë zonën e shërbimit,*
  - 1.6. *Është në interesin publik që t'i jipet KRU-së e drejta ekskluzive për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit brenda territorit të Komunës,*
  - 1.7. *Bashkëpunimi efektiv dhe koordinimi i aktiviteteve ndërmjet Komunës dhe KRU-së është i domosdoshëm për ofrimin e shërbimeve cilësore të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura në tërë territorin e komunës në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm.*

## **Neni 2** **Përkufizimet**

Për qëllimet e kësaj Marrëveshje, fjalët dhe shprehjet në vazhdim do ta kenë kuptimin si vijon:

**“Autorizim”** nënkupton të drejtën ekskluzive të cilën Komuna ia jep KRU-së për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza në territorin e Komunës;

**“Datë efektive”** nënkupton datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje;

**“Kërkesë ligjore”** nënkupton të gjitha ligjet, aktet nënligjore, urdhëresat, licencat, lejet, dhe rregullat në fuqi të nxjerra nga institucionet kompetente që kanë juridikcion mbi çështjen në fjalë;

**“KRU”** nënkupton Kompaninë Rajonale të Ujit

**“Komunë”** Njësi administrative e përcaktuar sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale;

**“Marrëveshje e shërbimit”** - marrëveshja e nënshkruar nga Komuna dhe Ofruesit e shërbimeve nën kontrollimin dhe mbikqyrjen e Autoritetit, për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit brenda Komunës së veçantë, në të cilën janë të përcaktuara të drejtat dhe obligimet e të dy palëve;

**“Kohëzgjatje”** nënkupton afatin e aplikueshmërisë së kësaj Marrëveshjeje;

**“Legjislacioni në fuqi”** nënkupton ligjet dhe aktet nënligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës;

**“Forcë Madhore”** nënkupton çdo ngjarje që ndodhë përtej kontrollit të arësyeshem të KRU-së e që i shkakton asaj vonesa apo pengesa në përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje; rastet e Forcës Madhore përfshijnë fatkeqësitë natyrore apo fatkeqësitë tjera të përkufizuara me ligj.

**“NJPM të NP”** nënkupton Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike e themeluar me Ligjin për Ndërmarrjet Publike;

**“Rregullatori”** nënkupton Autoritetin Rregullator për Shërbime të Ujit;

**“Shërbimet e ujërave të ndotura”** nënkupton grumbullimin, bartjen, trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të ndotura të përdorura nga shfrytëzuesit shtëpiak, komercial, industrial dhe publik;

**“Shërbimet e ujësjellësit”** nënkupton marrjen, trajtimin dhe distribuimin e ujit për konsum njerëzor si dhe operimin e rrjetit dhe objekteve që përdoren për këtë qëllim;

**Standardet e shërbimit** - nënkuptojnë standardet e shërbimit që zbatohen për atë shërbim në përputhje me legjislacionin aktual;

**Tarifa e shërbimit** - vlera, ngarkesa apo tarifa fikse të ofruesit të shërbimeve me të cilën ofruesi i shërbimeve e ngarkon konsumatorin në lidhje me ofrimin e shërbimeve;

**Zona e shërbimit** - zona e shërbimit e cila është përcaktuar me aktin nënligjor të miratuar nga Qeveria e Kosovës.

### **Neni 3**

#### **Lënda e kësaj marrëveshje**

Komuna, me këtë Marrëveshje, i jep të autorizimin KRU-së dhe të drejtën ekskluzive që gjatë afatit të kësaj Marrëveshje të ofrojë shërbimet e ujësjellësit dhe shërbimet e ujërave të ndotura në tërë territorin e Komunës

1. Dhënia nga Komuna e të drejtës ekskluzive KRU-së nënkupton që KRU të operojë në pajtim legjislacionin në fuqi, duke pasur parasysh si vijon:
  - 1.1 KRU duhet të operojë me objektet dhe pajisjet e saj që i shfrytëzon për ofrimin e shërbimeve në pajtim me praktikat e mira për shërbimet publike.
  - 1.2 KRU duhet të ofrojë shërbime të sigurt, të cilësisë së duhur dhe jodiskriminuese në asnjë aspekt, dhe poashtu të bëjë përmirësimet, zgjerimet dhe ngritjen e kapaciteteve në përputhje me rritjen e konsumatorëve sipas nevojës;
  - 1.3 Në rast të ndonjë ngjarje *Forcë Madhore*, Palët do të bashkëpunojnë në përpjekje që të krijohen mundësi për ofrimin e shërbimeve të sigurt dhe të vazhdueshme për të gjithë konsumatorët konfrom situatës së krijuar.
2. Shërbimet e operimit dhe mirëmbajtjes së kanalizimit të ujërave atmosferike nuk janë pjesë e kësaj Marrëveshje.

### **Neni 4**

#### **Parimet udhëheqëse të kësaj marrëveshje**

1. Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit të ujërave të ndotura janë veprimtari me interes publik.
2. Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit të ujërave të ndotura ofrohen ashtu që të sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm dhe rritja e vazhdueshme e cilësisë së këtyre shërbimeve.
3. Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit të ujërave të ndotura duhet të ofrohen mbi parimin e jodiskriminimit dhe duke zbatuar në tërësi legjislacionin në fuqi si dhe vendimet e Rregullatorit dhe autoriteteve tjera që kanë kompetenca në bazë të ligjit në fusha të caktuara të veprimtarisë së KRU-së.
4. Është me rëndësi esenciale që të këtë një bashkëpunim gjithëpërfshirës dhe efektiv ndërmjet Palëve në funksion të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, e në veçanti për investimet e nevojshme në sistemet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura me qëllim optimizimit të përfitimeve nga këto investime për cilësinë e shërbimeve për qytetarët dhe qëndrueshmërinë e këtyre investimeve.

### **Neni 5**

#### **Rregullimi i shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura**

Palët kanë parasysh se rregullimi i veprimtarisë së KRU-së i nënshtrohet *Ligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit* për zbatimin e të cilit është përgjegjës Rregullatori, ndërkaq çështjet që kanë të

bëjnë me pronësinë, qeverisjen korporative, llogaridhënien dhe raportimin i nënshtrohen *Ligjit për Ndërmarrjet Publike*. Çfarëdo konflikti ndërmjet kësaj Marrëveshje dhe këtyre ligjeve do të zgjidhet në favor të këtyre ligjeve si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

## **Neni 6** **Obligimet e KRU-së**

1. Obligimet e KRU-së sipas kësaj Marrëveshje përfshijnë:
  - 1.1 t'i ofrojë shërbimet sipas kësaj Marrëveshje në mënyrë efektive dhe efçente në pajtim me Standardet e Shërbimit;
  - 1.2 të zhvillojë dhe zbatojë politika dhe procedura operative për ofrimin e shërbimeve sipas kësaj Marrëveshje, duke përfshirë politikën dhe procedurat për (i) lidhjen e konsumatorëve në sistemin e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, (ii) matjen dhe faturimin, (iii) ndërprerjen e shërbimeve dhe (iv) zgjidhjen e ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve;
  - 1.3 t'i planifikojë investimet kapitale përmes planeve të veta të biznesit dhe planeve afatgjata të investimeve duke u konsultuar me Komunën dhe duke marrë parasysh propozimet e Komunës;
  - 1.4 t'i aplikojë tarifën e shërbimit të cilat janë aprovuar nga Rregullatori në pajtim me rregullat dhe metodologjinë e aplikueshme;
  - 1.5 t'i ndërmarrë të gjitha masat e duhura, për zvogëlimin e humbjeve të ujit;
  - 1.6 t'i vë në dispozicion të Komunës raportet të cilat i dorëzon tek NJPM e NP dhe ARRU për çështjet financiare, operative dhe të cilësisë së shërbimeve në pajtim me obligimet e përcaktuara në bazë të ligjit;
  - 1.7 ta informojë Komunën mbi aktivitetet e KRU-së në formën dhe shpeshtësinë siç merren vesh Palët;
  - 1.8 të bashkëpunojë ngushtë me Komunën dhe autoritetet tjera relevante në rastet e thatësisë kur zvogëlohen apo kur ka paralajmërime që mund të zvogëlohen kapacitetet e burimeve të ujit dhe të koordinojë veprimet për menaxhimin e situatës;
  - 1.9 të bashkëpunojë ngushtë Komunën dhe autoritetet tjera relevante në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera të cilat mund ta rrezikojnë furnizimin me ujë apo cilësinë e ujit;
  - 1.10 me rastin e kryerjes së punimeve në ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit të sigurojë paraprakisht pëlqimet dhe lejet komunale në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret komunale;
  - 1.11 t'i respektojë rregulloret dhe procedurat e komunës me rastin e kryerjes së lidhjeve individuale të konsumatorëve në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit;

- 1.12 t'i zbatojë procedurat dhe rregulloret komunale për dhënien e kushteve për lidhje në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit në procesin e shqyrtimit dhe dhënies së lejeve ndërtimore për investitorët dhe zhvilluesit e ndërtimeve të reja;
  - 1.13 t'i ndërmerrë të gjitha vendimet dhe veprimet e duhura, në pajtim me legjislacionin në fuqi, të cilat janë të nevojshme për përmbushjen e obligimeve të kësaj Marrëveshje;
  - 1.14 t'i informojë rregullisht dhe me kohë konsumatorët dhe komunën me të gjitha zhvillimet që lidhen me ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, në veçanti për rastet e ndërprerjes së imponuar të shërbimeve apo në rastet e problemeve me cilësinë e ujit.
2. Obligimet e KRU-së sipas kësaj Marrëveshje përmbushen me kusht që:
- 2.1 komuna i përmbush obligimet e saj sipas kësaj Marrëveshje,

## **Neni 7**

### **Obligimet e Komunës**

1. Obligimet e Komunës sipas kësaj Marrëveshje përfshijnë:
  - 1.1 t'i paguajë me kohë faturat e KRU-së për shërbimet që i ofrohen Komunës apo institucioneve tjera që financohen prej buxhetit të saj;
  - 1.2 t'i lejojë KRU-së ofrimin e shërbimeve në mënyrë efektive dhe efiçente pa u penguar nga administrata komunale;
    - 1.2 a) KRU Hidrodrini dhe Komuna e Klinës pajtohen që dëmet e shkaktuara nga kompania KRU Hidrodrini lidhur me rregullimin e rrjetit të ujësjellësit apo kanalizimit dhe punën që ndërlimet me kompaninë në fjalë t'i merr përsiper komuna për riparim dhe kthim në gjendjen e mëparshme. Ndërsa obligohet KRU Hidrodrini që koston për riparimin e këtyre dëmeve të ia paguajë komunës së Klinës. Shuma e pagesës caktohet sipas kontratave ekzistuese që ka komuna me OE përkatës për llojin e dëmit të shkaktuar (asfalt, kanalizim, dhe lloje të tjera të dëmeve).
  - 1.3 t'i ofrojë me kohë KRU-së informata relevante për planifikimin, zhvillimin dhe zgjerimin e Komunës në mënyrë që KRU t'i shqyrtojë ato informata dhe t'i përfshijë në planet e saj të investimeve kapitale dhe operative;
  - 1.4 t'i bartë asetet infrastrukturore të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura tek KRU në pajtim me dispozitat e *Ligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit*;
    - 1.4 a) Lista e fshatave që mund të merren ujrat e zeza në menaxhim (pasi këto fshatra kanë furnizim me ujë dhe menaxhohen nga KRU-ja) janë: Kpuz, Qeskove, Dollove, Zajm, Videj, Polce, Deiq, Berkove, Dresnik, Dollc, Klinavc, Pogragje, Jashanic, Dush, Jelloc, Gjurgjevik i madhe (40% për momentin), Siqev, Ujemir, Shtaric, Gjurgjevik i vogël, Kerrnic, Shtupel, Dush i Sferrikes etje, gjithmon nëse kanë rrjet të shtrir të kanalizimit.

1.4 b) Komuna dhe KRU marrin për obligim krijimin e një komisioni të përbashkët i cili do të bëjë vlerësimin teknik të gjendjes ekzistuese të kanalizimit në terren.

1.5 c) Komuna dhe KRU Hidrodrini marrin për obligim që me bartin e aseteve të ujësjellësit të barten edhe kanalizimi edhe në fshatrat që momentalisht nuk janë në menaxhim të KRU Hidrodrinit.

1.5 t'i zbatojë masat për mbrojtjen e zonave të mbrojtura të burimeve të ujit në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm, duke përfshirë këto zona në planin e tyre zhvillimor dhe rregullues si dhe në hartat zonale të komunës, si dhe duke ndërmarrë masat mbrojtëse në pajtim me kompetencat ligjore;

1.6 ta informojë dhe të bashkëpunojë ngushtë me KRU-it në të gjitha fazat e investimeve që mund t'i bëjë Komuna në sistemin e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura në territorin e vet duke përfshirë: planifikimin, projektimin, mbikqyrjen dhe pranimin teknik të objekteve dhe rrjetit që shërben për shërbimet e ujësjellësit dhe ujëra të zeza;

1.7 ta përfshijë KRU-në në procesin e dhënies së pëlqimit në projektin e instalimeve të brendshme të ujësjellësit dhe kanalizimit në mënyrë që të zbatohen kushtet teknike të lidhjes së objekteve të reja në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit të ujërave të ndotura;

1.8 të bashkëpunojë me KRU-në në procesin e menaxhimit të situatave të thatësisë dhe fatkeqësive tjera në pajtim me kompetencat e veta dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi;

1.9 ta mbështesë KRU-në në procesin e integritit të sistemeve rurale të ujësjellësit nën menaxhimin e KRU-së në pajtim me politikën e Qeverisë të Republikës së Kosovës për sektorin e shërbimeve të ujit;

1.10 t'i shqyrtojë dhe komentojë programet e investimeve kapitale të KRU-së në mënyrë që të arrihet koordinim me objektivat planifikuese të Komunës;

1.11 t'i ndërmerrë të gjitha vendimet dhe veprimet e duhura në pajtim me legjislacionin në fuqi që janë të nevojshme për përmbushjen e obligimeve të kësaj Marrëveshje.

2. Obligimet e Komunës sipas kësaj Marrëveshjeje përmbushen me kusht që:

2.1 KRU i përmbush obligimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje;

## **Neni 8** **Lehtësimet**

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje dhe gjatë kohëzgjatjes së saj, KRU-së i jipet e drejta e shfrytëzimit të hapësirës mbi, nën, përgjatë ose në objekte publike, ura dhe pronë tjetër publike duke përfshirë rrugët, trotualet, autostradat dhe hapësirat e gjelbëruara me qëllim të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së tubacioneve nëntokësore, pusetave dhe objektet tjera të ngjashme që

mund të jetë e nevojshme dhe e përshtatshme për ofrimin e shërbimeve sipas kësaj Marrëveshje (që referohet si e " E Drejta e Shfrytëzimit të Pronës Publike").

2. KRU autorizohet dhe ka të drejtë në shfrytëzimin e pronës publike sipas kësaj Marrëveshje, me kusht të respektimit të sigurisë publike dhe të aspekteve shëndetësore të përcaktuara me ligj dhe rregulloret e Komunës.
3. Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje, KRU duhet që në bashkëpunim me organet kompetente të Komunës dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi t'i kryejë të gjitha gërmimet nëpër rrugë, trotuare, autostrada dhe sipërfaqe publike në kohën dhe formën e duhur me qëllim që të shkaktohen sa më pak pengesa për shfrytëzimin publik të asaj prone publike në mënyrën më të përshtatshme për rrethanat e caktuara.
4. Pas kryerjes së punëve të ndërtimit dhe/ose mirëmbajtjes së sistemit të ujësjellësit në sipërfaqe publike, KRU duhet ta kthejë atë pronë publike në gjendjen që ka pasur para kryerjes së gërmimit.

#### **Neni 9**

##### **Kërkesat ligjore dhe ndihma nga Komuna**

1. Komuna nuk do të shkaktojë apo mbështesë miratimin, zbatimin apo aplikimin e çfarëdo kërkesë ligjore ndaj KRU-së e cila nuk ka ekzistuar në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje.
2. Komuna do të bëjë përpjekje të arsyeshme për ta ndihmuar KRU-në për marrjen nga Komuna dhe departamentet e Komunës autorizimet, lejet e ndërtimit, lejet tjera, pëlqimet, aprovimet, certifikatat dhe dokumentet tjera dhe do të ndërmerr veprime të duhura sipas nevojës ose në pajtim me ligjin ose rregulloret komunale me qëllim që t'ia lehtësojë KRU-së operimin, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e shërbimeve sipas kësaj Marrëveshje, me kusht që për një gjë të tillë të mos kërkohet që Komuna të parashtrijë kërkesë në emër të KRU-së.
3. Komuna do të bëjë përpjekje të arsyeshme për ta ndihmuar KRU-në për marrjen e shpejtë të çfarëdo leje, pëlqimi dhe të drejte të shfrytëzimit të pronës private, apo të dokumenteve tjera ose veprimeve të nevojshme që kërkohen nga cilido organ zyrtar i Kosovës në lidhje me operimin, mirëmbajtjen ose zgjerimin e shërbimeve sipas kësaj Marrëveshje, me kusht që për një gjë të tillë të mos kërkohet që Komuna të parashtrijë kërkesë në emër të KRU-së.
4. Komuna do të ofrojë ndihmën e vet për zbatimin e udhëzimeve dhe urdhëresave për kursimin e ujit sipas kërkesave të KRU-së.

#### **Neni 10**

##### **Tarifa për shërbime të ofruara**

1. Tarifat me të cilat KRU faturon konsumatorët për shërbimet e ofruara aprovohen nga Rregullatori me nxjerrjen e urdhëresës tarifore.



2. Çfarëdo shërbimi që mund të kërkohet nga Komuna e që nuk është përfshirë me urdhëresë tarifore të aprovuar nga Rregullatori, përfshirë këtu mirëmbajtjen e kanalizimit të ujërave atmosferike, duhet të rregullohet me marrëveshje/kontratë të veçantë ndërmjet Palëve.
3. Uji nga sistemi publik i ujësjellësit që përdoret nga Njësia e Zjarrfikësve për fikjen e zjarrit nuk do të faturohet nga KRU.

#### **Neni 11**

##### **Ndërprerja e shërbimeve për Komunën**

1. Komuna dhe departamentet e saj do t'i nënshtrohen të drejtës së KRU-së për ndërprerjen e shërbimit në rast se nuk paguajnë faturat e pagueshme në afatin e paraparë në pajtim me ligjin.
2. Për shkollat, departamentin e zjarrfikësve, spitalet dhe institucionet tjera shëndetësore, KRU do të bëjë përpjekje që pagesën e faturave ta realizojë me mjete tjera ligjore.

#### **Neni 12**

##### **Mosmarrveshja nga palët për obligimet e kësaj marrëveshje**

1. Në rast se ndonjëra prej Palëve vlerëson se Pala tjetër nuk i ka pëmbushur obligimet e kësaj Marrëveshje, çështjen do ta adresojë tek Rregullatori i cili do ta shqyrtojë atë mbi bazën e legjislacionit në fuqi.
2. Nuk do të konsiderohet se ka pasur mospërbushje të obligimeve nëse Pala ka qenë e penguar të përbushi ndonjë nga obligimet e saj sipas kësaj Marrëveshje për shkak të ngjarjes së *Forcës Madhore*.

#### **Neni 13**

##### **Ndashmëria**

Të gjitha klauzolat e kësaj Marrëveshje janë të veçanta dhe të ndara, dhe nëse ndonjë nga këto klauzola konsiderohet e paligjshme, anulohet ose bëhet e pazbatueshme, e njëjta nuk do këtë ndikim në validitetin, legalitetin ose zbatueshmërinë e klauzolave tjera.

#### **Neni 14**

##### **Ligji i aplikueshëm**

Kjo Marrëveshje interpretohet dhe qeveriset sipas legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 15**

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Në rast të mosmarrëveshjeve, kontradiktave apo ankesave që mund të dalin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, Palët do të bëjnë përpjekje që t'i ato në mënyrë miqësore.
2. Kur mosmarrëveshjet nuk mund të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe në baza të vuullnetit të mirë, ato do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata me juridiksion kompetent në Kosovë.

## Neni 16 Kohëzgjatje

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në *Datën Efektive* dhe do të këtë kohëzgjatje fillestare prej katër (4) vitesh prej datës së hyrjes në fuqi. Pas skadimit të këtij afati, Marrëveshja përtërihet automatikisht çdo katër (4) vjet, përveç nëse njëra Palë e njofton me shkrim Palën tjetër se dëshiron ta rishikojë Marrëveshjen. Njoftimi në këtë rast duhet të bëhet së paku tre (3) muaj para përfundimit të afatit të skadimit të Marrëveshjes.

## Neni 17 Modifikimi i marrveshshes

Modifikimi i kësaj Marrëveshje mund të bëhet shkrim, me nënshkrim e të dyja Palëve.

## Neni 18 Numri i kopjeve të marrveshshes

Kjo Marrëveshje nënshkruhet në së paku 3 kopje origjinale prej të cilave nga një kopje u shpërndahet Palëve dhe një kopje Rregullatorit.

Për dhe në emër të Komunës së Klinës

  
Kryetar i Komunës

Datë: \_\_\_\_/\_\_\_\_/2023

Për dhe në emër të KRU "Hidrodrini" Sh.A. Pejë

  
Kryeshf Ekzekutiv i KRU

Datë: 02/10/2023

